

VENDIM
Nr. 128, datë 16.8.2017

**MBI MIRATIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “AYEN AS ENERGJI” SHA PËR
MODIFIKIMIN E LICENCËS SË “PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE” NR. 273,
SERIA PV15K, TË MIRATUAR ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 32, DATË
4.3.2015**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 43 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”; vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 365, datë 4.5.2011, “Marrëveshje kocensionare me nr. 5446 Rep; nr. 1944 Kol., datë 2.5.2011”, të ndryshuar; nenit 15 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016; neni 15 të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit nr. 96, datë 17.6.2016, bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 16.8.2017, mbasi shqyrtoi relacionin për modifikimin e licencës së shoqërisë “Ayen As Energji” sh.a., përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut,

konstatoi se:

- Shoqëria “Ayen As Energji” sh.a. është licencuar në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC-et “Gojan”, “Gjegjan”, “Peshqesh” dhe “Fangu”, me fuqi totale të instaluar 110.54 MW, me vendimin e bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 32, datë 4.3.2015.

- Shoqëria “Ayen As Energji” sh.a. ka nënshkruar një kontratë shtesë të koncesionit me nr. 217 Rep., nr. 68/1 Kol., datë 20 janar 2017, “Për disa shtesa dhe ndryshime në kontratën e koncesionit të formës BOT”, kontratës koncesionare nr. 5446 Rep., nr. 1944 Kol., datë 2.5.2011; ndryshuar për sa vijon “Të zbatojë projektin për ndërtimin e hidrocentraleve të Peshqeshit, Ura e Fanit, Fangut, me një fuqi totale 109.71 MW.”

- Dokumentacioni i depozituar në ERE nga shoqëria “Ayen As Energji” sh.a., në bazë të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, rezulton si më poshtë:

- Neni 9, pika 1: germa “a” (të dhënat për aplikim), germa “b” (të dhëna identifikuese për aplikuesit) dhe germa “c” (të dhëna për aplikuesin). Plotësuar.

- Neni 15, pika 4, germa “a”, një informacion me shkrim, ku të shpjegohen arsyet e kërkesës për modifikimin e licencës. Plotësuar.

- Germa “b”, vendimin me shkrim të organeve drejtuese të të licencuarit, të cilat shprehin vullnetin për të kërkuar modifikimin e licencës. Plotësuar.

- Germa “c”, miratimin e modifikimit të parametrave dhe kushteve të tjera të licencës kur këto janë të kushtëzuara me miratimin nga organe të tjera. Plotësuar.

- Germa “d”, ndikimet e pritshme të modifikimit të licencës ndaj detyrimeve të të licencuarit sipas legjislacionit në fuqi. Plotësuar.

- Germa “e”. Të ketë kryer pagesat e rregullimit në ERE, plotësuar.

- Në vendimin nr. 105, datë 10.7.2017, bordi i ERE-s vendosi: fillimin e procedurës për modifikimin e licencës së shoqërisë “Ayen As Energy” sh.a., dhënë me vendimin e bordit të komisionerëve të ERE-s nr. 32, datë 4.3.2015, me nr. 273, seria PV15K, për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC-et e “Gojanit”, “Gjegjanit”, “Peshqesh”, “Ura e Fanit” dhe “Fangu”, me fuqi totale 110.54 MW, në përputhje me parashikimet e kontratës shtesë të koncesionit me nr. 217 Rep., nr. 68/1 Kol., datë 20 janar 2017, “Për disa shtesa dhe ndryshime në kontratën e koncesionit të formës BOT”, kontratës koncesionare nr. 5446 Rep., nr. 1944 Kol., datë 2.5.2011.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të modifikojë licencën e shoqërisë “Ayen As Energji ” sh.a., me numër me nr. 273, seria PV15K, për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC-et “Gojan”, me fuqi 12.25 MW, “Gjegjan”, me fuqi 6.55 MW, “Peshqesh”, me fuqi 27.94 MW dhe “Fangu”, me fuqi 63.8 MW, me fuqi totale 110.54 MW, për një afat 30-vjeçar, lëshuar me vendim të bordit të komisionerëve të ERE-s nr. 32, datë 4.3.2015.

2. Emërimi i HEC-ve do të jetë: “Peshqesh”, me fuqi 34 MW; “Ura e Fanit”, me fuqi 1.11 MW, dhe “Fangu”, me fuqi 74.6 MW, me një fuqi totale të instaluar 109.71 MW.

3. Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti